



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kuvendit Komunal



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		25.09	2025
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02-400101-		42586	

R A P O R T

I

DËGJIMEVE BUXHETORE

PËR

BUXHETIN E KOMUNËS PËR VITIN 2026

DHE

DHE PROJEKSIONET PËR VITET 2027 - 2028

Shtator, 2024

Hyrje

Përmes këtij Raporti përmbledhës të Konsultimeve Publike synohet që të dokumentohen të gjitha format e konsultimit publik që i kanë paraprirë përpilimit/draftimit të projekt-propozimit të buxhetit nga ana e ekzekutivit të komunës. Kjo nënkupton që përfshihen takimet publike obligative të mbajtura në gjashtëmujorin e parë nga ana e Kryetarit, format të konsultimit publik në të shkruar, dëgjimet buxhetore për KAB e po ashtu ato për buxhet vjetor, etj.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, përcaktohen rregullat që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve përfaqësuese në vendimmarrje lokale, transparencën dhe llogaridhënien e organeve të komunës, gjithashtu përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore në komunë si dhe obligimet e komunave për të siguruar qasjen nëpërmjet teleprezencës dhe teknologjisë digjitale për të garantuar transmetimin në distancë dhe monitorimin nga autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe qytetarët. Sipas këtij Udhëzimi, Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e: 1.1 Takimeve publike; 1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave; 1.3 Takime konsultative me qytetarë; 1.4 Dëgjime buxhetore.

Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale. Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt- propozimit gjatë mbajtjes së konsultimit publik mbledh komentet dhe përgatit raport për rezultatet e konsultimit publik.

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, respektivisht Nenit 60, përcaktohet se përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore bëhet nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe Kryetari i Komunës, ku ZKF duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t'i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi

- (i) tavanet e shpenzimeve të aplikueshme për departamentin përkatës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime mbi këto tavane për dy (2) vitet e ardhshme fiskale, dhe
- (ii) metodologjinë dhe formularët që duhet të shfrytëzohen nga departamenti përkatës gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal. Kjo qarkore buxhetore duhet të përfshijë: a) procedurat që duhet përdorur nga departamenti gjatë përgatitjes së propozim buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore; b) të dhënat të cilat duhet të parashtrohen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore; c) detale mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore; dhe d) afatin e fundit deri në të cilin departamenti duhet të përfundojë dhe t'i dorëzojë ZKF-së propozimbuxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

Pas miratimit të propozim-Buxhetit Komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës, deri me 1 Shtator të vitit përkatës fiskal, duhet t'ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal. Propozim-Buxheti Komunal duhet të përfshijë:

- a) parashikime dhe supozime ekonomike dhe buxhetore;
- b) vlerësime të përgjithshme të të ardhurave nga të gjitha burimet, duke përfshirë (i) grantet, në përputhje me shumat e këshilluara në qarkoren(t) buxhetore të nxjerra nga Ministri, (ii) ndihmën nga burimet jashtë Kosovës, dhe (iii) të ardhurat e parashikuara vetanake të komunës;
- c) një cak të përgjithshëm të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimit;
- d) vlerësime të përkrahjes së pritur nga donatorët; dhe

e) çfarëdo të dhëna të tjera me rëndësi materiale për buxhetin të cilat ZKF e konsideron të arsyeshme për t'u përfshirë.

1.1 ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN DHE PËRPILIMIN E PROPOZIM-BUXHETIT KOMUNAL

Grupi punues i mbështetur nga projekti DEMOS ka realizuar një punëtori dy ditore për hartimin e planit të dëgjimeve buxhetore e po ashtu për mënyrën e planifikimit, organizimit, lehtësimit dhe veprimeve përcjellëse të dëgjimeve buxhetore dhe gjithë procesit të planifikimit të buxhetit.

Plani i dëgjimeve buxhetore është hartuar dhe gjithashtu është publikuar në ueb faqen dhe rrjetet sociale të Komunës.

Hartimi i këtij dokumenti ka ardhur edhe pas mbajtjes së konsultimeve publike (dëgjimeve buxhetore) me qytetarët për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe atyre për projekt-propozimin e buxhetit për vitin 2026.

Pas themelimit të Grupit Punues për dëgjimet buxhetore 2025–2027, sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Drenasit nr. 01-400/01-8037, të datës 27/02/2025, dhe shpalljes së ftesës për pjesëmarrje në dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028, nr. 01- 060/03-18323, të datës 19/05/2025, janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar një proces të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent. Këto veprime janë bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Të gjithë qytetarët, administratorët e vendbanimeve, përfaqësuesit e lagjeve, OJQ-të, shoqatat e grave, shoqëria civile, bizneset dhe palët e tjera të interesuara janë njoftuar se më datën 19.05.2025 kanë filluar dëgjimet buxhetore për pranimin e komenteve, propozimeve dhe kërkesave për hartimin e KAB-it 2026–2028. Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft-Buxheti Komunal 2026–2028 kanë qenë dhe mbeten dokumente me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe mirëqenien e komunës, prandaj pjesëmarrja aktive e qytetarëve ka qenë thelbësore për të ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Komentet dhe propozimet janë pranuar deri më 30.05.2025, ora 16:00, në adresat zyrtare të emailit: albulena.saliuku@rks-gov.net, bekim.dobra@rks-gov.net, avdyl.mziu@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net.

Në të dy dëgjimet buxhetore të mbajtura për KAB 2026-2028, temat kryesore ishin të fokusuara në:

- Hartimin dhe prezantimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028
- Prioritetet investuese për infrastrukturën rrugore, ujësjellësit, ndriçimin publik dhe kanalizimin
- Përmirësimin e kushteve në arsim dhe kujdes shëndetësor
- Mbështetjen për zhvillimin rural dhe bujqësinë
- Aktivitetet rinore, kulturore dhe sportive
- Rritjen e transparencës dhe digjitalizimin e shërbimeve komunale.

Publikimet për këto dëgjime buxhetore janë të vendosura në linqet në vijim:

Link – Plani i konsultimeve publike me qytetarë për vitin 2025

<https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/12/Plani-i-punes-dhe-plani-i-konsultimit-publik-2025.pdf>

Link – Ftesë për pjesëmarrje në dëgjetimet buxhetore për KAB 2026-2028

<https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Ftese.pdf>

Link – Kalendar i Dëgjimeve Buxhetore për Projekt-Propozim Buxhetin 2026 <https://gllogoc.rks-gov.net/news/komuna-e-drenasit-publikon-kalendarin-e-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026/>

Link – Moduli i dëgjimeve buxhetore në uebfaqen komunale ku gjenden të gjitha dokumentet që i nënshtrohen dhe janë relevante për konsultimet publike që kryen komuna e Drenasit

<https://gllogoc.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/>

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2026

Dëgjimi publik i thirrur nga Komiteti për Politikë dhe Financa kishte si të ftuar qytetarët e Komunës së Drenasit dhe administratorët e vendbanimeve. Ky dëgjim kishte për objekt shqyrtimin e buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin për vitin 2026 si dhe projeksionet për vitet 2027- 2028.

Në takim ishin të pranishëm:

Arben Shala	Nënkryetar i Komunës së Drenasit
Bekim Lestrani	Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Kushtrim Bajraktari	Zyrtar Kryesor Financiar
Bekim Dobra	Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun
Hamit Kastrati	Asamblist i Kuvendit Komunal
Hamit Haxhiu	Asamblist i Kuvendit Komunal
Laureta Thaqi	Drejtoreshë e Administratës së përgjithshme
Herolinda Krasniqi	Drejtoreshë e Kulturës Rinis dhe Sportit
Lumnije Krapci	Drejtoreshë e Shëndetësisë

Procesi i hartimit të projekt-buxhetit të vitit 2026 i është paraprirë nga hartimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB) 2026-2027. Pas themelimit të Grupit Punues për dëgjetimet buxhetore 2025–2027, sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Drenasit nr. 01-400/01-8037, të datës 27/02/2025, dhe shpalljes së ftesës për pjesëmarrje në dëgjetimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028, nr. 01- 060/03-18323, të datës 19/05/2025, janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar një proces të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent. Këto veprime janë bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Në kuadër të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Planin e Brendshëm të Veprimit për organizimin e dëgjimeve buxhetore 2025, ku janë specifikuar detyrimet ndërinstitucionale me qëllim të organizimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore.

Publikimet për këto dëgjime buxhetore janë të vendosura në linqet në vijim:

Link – Plani i konsultimeve publike me qytetarë për vitin 2025

<https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/12/Plani-i-punes-dhe-plani-i-konsultimit-publik-2025.pdf>

Link – Ftesë për pjesëmarrje në dëgjetet buxhetore për KAB 2026-2028

<https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Ftese.pdf>

Link – Kalendar i Dëgjimeve Buxhetore për Projekt-Propozim Buxhetin 2026 <https://gllogoc.rks-gov.net/news/komuna-e-drenasit-publikon-kalendarin-e-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026/>


Link – Moduli i dëgjimeve buxhetore në uebfaqen komunale ku gjenden të gjitha dokumentet që i nënshtrohen dhe janë relevante për konsultimet publike që kryen komuna e Drenasit

<https://gllogoc.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/>

Kalendar i dëgjimeve buxhetore: <https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendar-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf>

Pjesëmarrja

Gjatë dëgjimeve buxhetore, pjesëmarrja ishte relativisht e kënaqshme. Në këtë dëgjim buxhetor, numri total i pjesëmarrësve ishte *19, prej 08 ishin femra dhe 11 meshkuj.*



Kërkesat, sugjerimet dhe komentet e parashtruara ishin kryesisht të natyrës së ngjashme, duke përfshirë: ndriçimin publik, infrastrukturë rrugore (mirëmbajtja, shtrimi dhe asfaltimi i rrugicave dhe trotuareve), ujësjellës dhe kanalizim.

Kërkesat, sugjerimet dhe komentet e paraqitura në formë tabelore:

Të gjitha kërkesat e parashtruara, sugjerime dhe komentet në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë tabelore në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Ndarja gjinore	Ndarja mbi bazat gjinore të kërkesave
Dëgjimeve buxhetore për të gjithë qytetaret e Komunës së Drenasit organizuar nga Komiteti për politik dhe financa dhe Kuvendi i Komunës	05.09.2025 Ora: 11:00	19 pjesëmarrës	3	3 M 0 F	3 M 0 F

Projekt buxheti i vitit 2026, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe jo me larg se **30 shtator 2025** të miratohet në Kuvendin e Komunës së Drenasit.

Kategorizimi i kërkesave	Numri
Kapitale	3
Mallra dhe shërbime	0
Subvencione	0
Paga dhe mëditje	0

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e lëgimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2025	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)	Kategorizimi i kërkesave
Dëgjimet buxhetore për vitin 2025	Në Dobroshec kërkoj 96 metra rrugë asfalt	Xhevdet Shehu Administator i fshatit Dobroshec:	<u>Pranohet pjesërisht</u>	Përgjigja: Grupi Punues	Kapitale
Dëgjimet buxhetore për vitin 2025	Kërkesat për trotuar kanalizim si dhe disa rrugica të pa asfaltuara, ndriçim dhe uji i pijes janë ai ato në vitin e kaluar që i kemi paraqitë në dëgjimet buxhetore.	Bajram Qallapeku, Administrator i fshatit Tërstenik I-II	<u>Pranohet pjesërisht</u>		Kapitale
Dëgjimet buxhetore për vitin 2025	Kërkesa për do rrugica për do dëgzime në lagjen Dvorani që është një nder lagjet me të mëdha , problemi kryesor është një rrugë që na lidh lagjen mes veti për shkakë që autostrada na e ka bërë 4 km me shku njeri të tjetri.	Agim Kacurreti përfaqësues i Terstenik I	<u>Pranohet pjesërisht</u>		Kapitale

Shtojca 2-Mënyra e informimit

Informimi për qytetarët është bërë në një format sa më atraktiv dhe informues, në mënyrë që qytetarët të jenë në dijeni për gjithçka në lidhje me buxhetin dhe projektet për vitin 2026. Prandaj, thirrja për dëgjimet buxhetore është bërë në mënyrën sa më ilustrative.

Komuna e Drenasit,

25.09.2025



Përpiluar nga:

Fakete Hoti